

HYRJE

Posedimi si institut juridik paraqet një gjendje faktike e cila gëzon mbrojtje juridike. Posedimi nuk konsiderohet e drejtë sendore por vetëm pushtet faktik mbi sendin, por edhe pse nuk është e drejtë e plotë sendore posedimi konsiderohet si e drejtë e kufizuar sendore e cila gëzon mbrojtje juridike. Posedimi është një gjendje faktike e cila duhet të mbrohet, andaj poseduesi ka të drejtë në mbrojtje nga shqetësimet ose nga marrja e sendit nga posedimi dhe në këtë rast poseduesi ka të drejtë të mbrohet me vetëndihmë dhe me padi.

Vetëndihma vjen në shprehje vetëm për mbrojtjen e pushtetit faktik dhe në rrethanat e lejuara nga Ligji, pra poseduesi ka të drejtë në vetëndihmë kundër çdo subjekti i cili në mënyrë të kundërligjshme e shqetëson atë në ushtrimin e posedimit. Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Kosovës parasheh se poseduesi mund ta përdorë forcën e arsyeshme për mbrojtje nga veprimet e paligjshme në pengimin e posedimit të tij, në qoftë se ndërhyrja është e atij çasti dhe janë ndërmarrë masat adekuate (proporcionale) për mbrojtje menjëherë me paraqitjen e rrezikut. Vetëndihmën poseduesi mund ta përdorë vetëm atëherë kur plotësohen kushtet e parapara me Ligj e të cilat janë: Rreziku duhet të jetë i drejtpërdrejtë; Vetëndihma duhet të jetë e nevojshme dhe Veprimi me vetëndihmë duhet ti përgjigjet rrethanave të rrezikut.

Posedimi përveç që mbrohet me vetëndihmë ai mbrohet edhe me padi. Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore parasheh dhe lejon padinë për pengim posedimi dhe padinë për kthim posedimi. Padia për pengim posedimi është padi të cilën e parashtron poseduesi vetëm në rastet kur ai pengohet në ushtrimin e pushtetit faktik mbi sendin e tij, pra ai ende e mbanë sendin në posedim por pengohet në ushtrimin e qetë të pushtetit faktik mbi të. Me padinë për pengim posedimi kërkohet ndërprerja e pengimit dhe ndalesa e pengimit në të ardhmen. Kërkesa për pengim posedimi sipas ligjit mund të parashtrohet vetëm brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur poseduesi merr dijeni për pengimin e posedimit, kjo kërkesë shuhet pas kalimit të afatit prej 1 viti nga pengimi i posedimit.

Ndërsa padia për kthim posedimi është padi e cila parashtrohet nga poseduesi kundrejt personit i cili ia ka marrë sendin nga posedimi dhe me këtë padi kërkohet të kthehet sendi në posedim. Në

këtë rast poseduesi është zhveshur plotësisht nga posedimi i sendit dhe kërkon nga gjykata mbrojtje, përkatësisht kthimin e sendit në posedim ku gjykata e vërteton vetëm gjendjen e fundit faktike. Kjo kërkesë sipas ligjit është padi që parashkruhet dhe e njëjta mund të parashtrohet vetëm brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur poseduesi merr dijeni për privimin e posedimit të tij, kjo kërkesë shuhet pas kalimit të afatit prej 1 viti nga privimi i posedimit.

Ky punim ka për qëllim që ta trajtoj mbrojtjen e posedimit si e drejtë e kufizuar sendore dhe pushtet faktik, kornizën ligjore dhe praktikën gjyqësore në Kosovë, andaj duke pasur parasysh grumbullimin e madh të lëndëve të fushës civile në Gjykatat e Republikës së Kosovës, e posaçërisht atyre të llojit të cenimeve të posedimit dhe duke pasur parasysh se posedimi është institut me rëndësi të veçantë në të drejtën civile është relevante që me anë të këtij punimi të sqarohet ky institut, se kur shkaktohet akti i pengim posedimit dhe si duhet të bëhet mbrojtja e tij në Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Posedimi është rregulluar me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore ndërsa procedura lidhur me mbrojtjen e tij është rregulluar me Ligjin për Procedurën Kontestimore në pjesën e procedurave të veçanta të tij.

Në kapitullin e parë të këtij punimi shkurtimisht do të trajtohet zhvillimi historik i institutit të posedimit, se çka e tërhoqi vëmendjen e juristëve romak se duhet të bëhej ndarja definitive në mes të posedimit dhe pronësisë. Në vijim të këtij kapitulli kemi trajtuar nocionin e posedimit dhe nocionin e pronësisë, duke vazhduar tek llojet dhe rëndësia e posedimit dhe në pjesën e fundit të këtij kapitulli është trajtuar fitimi dhe shuarja e posedimit.

Në kapitullin e dytë është trajtuar mbrojtja e posedimit, fillimisht se si posedimi mund të mbrohet me vetëndihmë nën kushtet e përcaktuara me ligj, më pas mbrojtja e posedimit me anë të padive. Paditë posedimore janë padia për pengim posedimi dhe padia për kthim posedimi, elementet e aktit të pengim posedimit, legjitimiteti i palëve në procedurë, objekti i padisë, kompetenca dhe procedura kontestimore, shqyrtimi i gjykatës, vendimi i gjykatës për kërkesëpadinë dhe mjetet e goditjes së vendimit meritor, specifikat dhe efikasiteti i kësaj procedure dhe dallimet në mes të padive posedimore dhe atyre pronësore.

Në kapitullin e tretë janë trajtuar disa raste të natyrës posedimore të cilat janë trajtuar dhe zgjidhur nga Gjykatat e Republikës së Kosovës, përkatësisht është bërë analiza e tyre veç e veç, se si është paraqitur padia për mbrojtje të posedimit dhe se si ka vendosur gjykata lidhur me secilin rast konkret duke pasur parasysh elementet dhe faktet relevante të rastit.